



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502453/2

Tiranë ___/___/2015

Lënda : *Rekomandohet revokimi i veprimeve përmbarimore për vjeljen e detyrimit në të holla nga të ardhurat e siguruar prej ndihmës ekonomike nga pala debiore dhe anëtarëve të familjes së tyre.*

Drejtuar : **Jordisa Dervishi, përmbaruese gjyqësore**
Adresa : Bulev "Zogu I", Rruga "Maliq Muço",
barimit

TIRANË

Për dijeni : **D.K.**
Adresa :

Tedi Malaveci
Kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat.

Llambriola Misto
Sekretare e Përgjithshme pranë Ministrisë së Drejtësisë

TIRANË

Zj/Znj. Përmbaruese gjyqësore,

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasës D.K, në të cilën ajo ka prezantuar shqetësimin e kryerjes nga ana juaj të veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv, Akt-marrje kredie bankare datë 29.08.2008, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr.4935 Akti, datë 15.12.2009, me objekt :

"Detyrimin e V.K. dhe D.K të paguajnë shumat në të holla sipas kushteve të vendosura në Akt-marrje kredie bankare datë 29.08.2008, të lidhur me Bankën Procredit", jo në përputhje me parashikimet e K.Pr.C.

Nga aktet e vëna në dispozicion prej ankueses, rezulton se, ju zj/znj. Përmbarese Gjyqësore, me rastin e kalimit të afatit për dorëzimin në mënyrë vullnetare të detyrimit, keni kryer veprime përmbarese për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv në fjalë, duke urdhëruar bankat e nivelit të dytë, me shkresën nr.00688 Prot, datë 26.09.2015, “Për vendosjen e sekuestrës” mbi llogaritë e mundshme të palës debitore.

Ka rezultuar, se, pala debitore ka gjendje në të holla, gjithësej 19763 Lekë, në llogarinë e saj pranë Bankës Societ Generale Albania, dhe se, ju, me shkresën nr.04733, datë 30.10.2015, keni urdhëruar transferimin e shumës së sekuestruar prej 19763 Lekë në llogarinë e Shoqërisë përmbarese “Star” Sh.p.k.

Pala debitore, shprehet, se, ka informuar subjektin tuaj që shuma në të holla prej 19763 Lekë, është krijuar nga të ardhurat e përmuajshme si ndihmë ekonomike për ta dhe anëtarët e familjes së tyre.

Referuar ekstraktit, datë 10.11.2015, të Bankës Societ Generale Albania, rezulton se, pala debitore, së bashku me anëtarët e familjes, përfiton për çdo muaj shumën prej 6.420 Lekë si ndihmë ekonomike.

Ndodhur në situatën e lartpërmendur, për të cilën jeni informuar prej palës debitore, veprimtaria për ekzekutimin e titullit ekzekutiv të lartpërmendur, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit nuk zhvillohet në kuptim dhe zbatim të drejtë prej jush, sikurse parashikuar dhe përcaktuar të aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 2 i ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbaremit gjyqësor”, të ndryshuar, parashikon se :

”Shërbimi i Përmbaremit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të tiujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile” .

Pra, vendosja e masës së sekuestrës mbi kreditë e debitorit, në rastin konkret, duhet të kryhet në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të dispozitave, neneve, 527, 529, 533, 581 dhe 582 të K.Pr.C.

Sipas parashikimeve të nenit 581 dhe 582 të K.Pr.C, paraprakisht, ju, zj/znj. Përmbarese, duhet të siguronit të dhëna për ekzistencën e kredive të palës debitore pranë personit të tretë (bankës së nivelit të dytë) si dhe marrjes së deklarimeve të debitorit rreth saktësisë së informacionit të siguruar. Me këtë rast, ju do të administronit dhe aktet që provojnë që shuma e sekuestruar, prej 19763 lekë, është e krijuar prej të ardhurave mujore nga ndihma ekonomike për familjen e debitorëve. Kjo situatë, në vështrim të nenit 529/6 të K.Pr.C. i cili parashikon se ;

“Përjashtohen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit:

- *ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se ½ e shumës së pensionit ose të bursës”.*

si dhe nenit 533 të K.Pr.C., i cili parashikon se:

“Pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, përmbaruesi gjyqësor sekuestron pagën e debitorit, por pa cënuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi”.

nuk lejon kryerjen e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, pasi të ardhurat e siguruara si ndihmë ekonomike, prej palës debitore dhe anëtarëve të tjerë të familjes së saj, janë në masën afro 1.250 Lekë në muaj për çdo anëtarë.

Kryerja nga ana juaj e veprimeve për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, duke vendosur për sekuestrimin e shumës prej 19763 Lekë, që i përket jo vetëm dy debitorëve solidar V dhe D.K, por edhe anëtarëve të tjerë të familjes së tyre, është tregues i cënimit nga ana juaj i parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të garantuar në nenin 42/2 të Kushtetutës si dhe nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Nuk mund dhe nuk duhet të kryhen nga ana juaj zj/znj përmbaruese gjyqësore, veprime për ekzekutimin e detyrueshëm të shumës në të holla, pa respektuar më parë parashikimet e nenit 581 dhe 582 të K.Pr.C., si dhe parashikimet e nenit 529/6 dhe 533 të K.Pr.C.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problem, çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankueses në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se:

“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”,

si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, i cili parashikon se:

“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

Revokimi i veprimeve përmbarimore për vjeljen e detyrimit në të holla nga të ardhurat e siguruara prej ndihmës ekonomike nga pala debiore dhe anëtarëve të familjes së tyre.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

Konc.Daktilografoi
A.Gjoleka